



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:126818

Datë: 23.05.2022

Numri i dokumentit: 03040091

**AC.nr.6833/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, nga gjyqtari individual Besnik Feka, me praktikanten e gjykatës Albana Kosova, në çështjen përmbareme të kreditores Xh.H.me numër personal ....., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat S.K.,kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës,Qendra Klinike Universitare e Kosovës,Prishtinë,lidhur me çështjen përmbareme pagesë borxhi,në vlerë prej 348.97 €, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr.1344/20 i datës 29.01.2021, me datë 19.05.2022, nxjerr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET E PABAZUAR** ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës-Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1344/20, i datës 29.01.2021, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr.1344/20, i datës 29.01.2021, në pikën I (një) të dispozitivit të aktvendimit e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës,Qendra Klinike Universitare e Kosovës, i paraqitur kundër urdhërit përmbareme, P.nr.802/20 i datës 28.05.2020, të përmbaremit privat A. M.,në Prishtinë, dhe urdhri për përmbareme ka mbetur në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori, përmes të autorizuarit të tij avokat S. K., me propozim që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit të Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, fillimisht duke u kujdesur për kompetencën e saj lëndore dhe funksionale, konstaton se ka kompetencë lëndore bazuar në nenin 3 par.2 të Ligjit për Procedurë Përmbareme e gjithashtu edhe funksionale ku përcaktohet se në shkallën e dytë në procedurën përmbareme vendos gjyqtari individual i gjykatës së shkallës së dytë, për vendosje sipas ankesës së ushtruar.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, në lidhje me nenin 201 pika b) dhe d), nenin 208 dhe neni 209 pika c) të LPK-së, gjeti se:

**-Ankesa e debitorit është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 28.05.2020, ka paraqitur propozim pranë organit përmbarues për caktimin e përmbarimit në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës.

Organi përmbarues me urdhrin, P.nr.802/2020, i datës 28.05.2020 e ka lejuar përmbarimin.

Debitori pas pranimit të urdhrin për përmbarim ka ushtruar prapësim pranë Gjykatës së shkallës së parë me propozim që të aprovohet prapësimi ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

I autorizuari i kreditorit avokat S.K. ka ushtruar pergjigje në prapësimin e debitorit, duke i propozuar gjykatës që prapësimin në fjalë ta refuzojë të pabazuar dhe të vërtetojë Urdhërin për Lejimin e Përmbarimit.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.1344/2020, i datës 29.01.2021 e ka refuzuar prapësimin duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të saj gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shikimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin për përmbarim të një vendimi administrativ, si dokument i përmbarimit dhe se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 1 par.2 të LPP-së dhe neni 21,22,23 par.2 dhe neni 24 par.3 të LPP-së. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se përkitazi me pretendimet e palës debitore të cekura në prapësimin e saj se vendimi administrativ në fjalë nuk mund të jetë titull ekzekutiv, si dhe Inspektorati i Punës nuk është organ kompetent për të vendosur për këtë natyrë, sipas gjykatës së shkallës së parë këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që vendimi administrativ në fjalë është bërë i ekzekutueshëm dhe i formës së prerë në procedurën administrative dhe si i tillë është bërë i përmbarueshëm edhe në procedurën e përmbarimit. Tutje në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë është vlerësuar edhe pretendimi i debitorit se organi përmbarues përmbaruesi privat nuk është kompetent për të zhvilluar dhe zbatuar procedurën përmbarimore, dhe ky pretendim është refuzuar me arsyetimin se rastet përmbarimore tanimë të lejuara nga përmbaruesi privat para datës 05.02.2021, duhet të vazhdojnë të zbatohen nga organi përmbarues-përmbaruesi privat, sipas Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës GJ.A nr, 36/21, dt: 05.02.2021, dhe meqenëse në rastin konkret përmbarimi është lejuar me dt: 28.05.2020, atëherë kompetenca e përmbaruesit privat në rastin konkret është e drejtë dhe e ligjshme për zbatim të përmbarimit.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë në rastin konkret nuk ekzistojnë asnjëra nga shkaqet e cekura në prapësimin e palës debitore, andaj gjykata të njëjtin e ka refuzuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Vendimin për shpenzimet e përmbarimit e ka marrë në përputhje me nenin 13 të LPP-së lidhur me nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, vendimin e gjykatës së shkallës së parë e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale,

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të palës debitore, mirëpo konsideron se të njëjtat janë të pa bazuara.

Gjykata e Apelit pas shikimit të shkresave të lëndës konsideron se nuk kemi të bëjmë me konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas asaj se çka i është ofruar në shkresat e lëndës e ka marrë vendimin për refuzimin e prapësimit të debitorit si të pa bazuar. Propozimi për përmbarrim është bërë në bazë të dokumentit përmbarrues –vendimit administrativ i përcaktuar me nenin 22 par.1 nën par 1.2 të këtij ligji i cili përcakton se: *“1. Dokumente përmbarruese janë: 1.2 1.2. vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia);”*, po ashtu Ligji për procedurën përmbarrimore e përcakton edhe çka konsiderohet vendim administrativ ku neni 23 par.2 përcakton se: *“2. Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendim dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktpajtim administrativ konsiderohet ujdia e arritur në procedurë administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”*, andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara kjo Gjykatë vlerëson se urdhri për përmbarrim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe i përmbanë të gjitha elementet e përcaktuara me këto dispozita andaj nuk ekziston asnjë shkak që kjo Gjykatë të mos e përkrahë vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm, ku detyrohet debitori Qendra Klinike Universitare e Kosovës-Prishtinë, që t’ia paguajë borxhin kreditorit, në vlerë prej 348.97 €, si dhe shpenzimet e avokatit: propozimin për përmbarrim 156.00 €, për përgjigje në prapësim shumë pre 156.00 €, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës përmbarrimore në përputhje me UA-MD Nr.06/2014.

Dokumenti përmbarrimor vendimi i Inspektoratit të Punës është i formës së prerë me dt: 03.07.2020, dhe i ekzekutueshëm me po të njëjtën datë 03.07.2020, andaj, bazuar në dispozitat e lartëcekura, i njëjti i plotëson të gjitha kushtet e një dokumenti përmbarrimor.

Në rastin konkret, kjo Gjykatë ka për detyrë që të vlerësojë vetëm se a janë ndërmarrë veprimet nga organi përmbarrues dhe Gjykata e shkallës së parë në përputhje me Ligjin për Procedurën Përmbarrimore, e jo të vlerësojë ligjshmërinë e vendimit në bazë të cilit është bërë propozimi për përmbarrim. Çdo dilemë në lidhje me ligjshmërinë e vendimit në bazë të të cilit është bërë propozimi për përmbarrim pala debitor mundet që ta adresojë në procedurë tjetër, mirëpo tani për tani në çështje kjo Gjykatë konsideron se propozimi për përmbarrim është bërë në bazë të dokumentit përmbarrues dhe i ka të gjitha tiparet e dokumentit të tillë, andaj nuk gjeti arsye që të mos e përkrahë vendimin e Gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Meqenëse debitori me ankesë nuk ka paraqitur asnjë shkak me të cilin do të vërtetonte se ekzistojnë arsyeje të cilat do të bënin dokumentin të pa përshtatshëm për tu përmbarruar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin si të pa bazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e konsideruar vendimin e gjykatës së shkallës së parë të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AC.nr.6833/21, me datë 19.05.2022**

**Gjyqtari Individual**  
**Besnik Feka**